



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
**KOMUNA E GJILANIT**  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari", pn, [vvgjilani-komuna.org](http://vvgjilani-komuna.org); zip [gjilan@hotmail.com](mailto:gjilan@hotmail.com), tel. 028/20 781, 20 782, 21 482.

---

## **PROPOZIM**

Në mbështetje të nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 , Nenit 5 të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L – 214, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale Nr. 10/2012 , duke u bazuar në Nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L – 040 dhe konform neneve 25 dhe 27 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së në mbledhjen e mbajtur me dt.....2014 miratoi në parim këtë:

## **RREGULLORE**

### **PËR DHËNIEN E LEJES MJEDISORE KOMUNALE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1.1 Qëllimi i kësaj Rregullore Komunale është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis të proj efektëve të propozuara nga subjektet publike dhe private.

1.2 Kjo Rregullore Komunale përcakton rregullat e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Komunës për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë ofruar dhe janë marrë parasysh.

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

2.1 Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

2.2 Raporti për leje mjedisore komunale (Raport i LMK) - nënkupton raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve ose projekteve në mjedis në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis;

2.3 GLN - Gaz i lëngëzuar naftor;

- 2.4 Ministria - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 2.5 Komuna – njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.
- 2.6 Kryetari – Kryetari i Komunës
- 2.7 Kryesuesi i Kuvendit
- 2.8 DUMM - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Mjedisit
- 2.9 Sektori i Mjedisit
- 2.10 Udhëheqësi /Zyrtari i lartë për Mbrojtjen e Mjedisit.
- 2.11 Leje Mjedisore Komunale (LMK) - është dokument me shkrim që e lëshon komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas ligjit;
- 2.12 KP – Komisioni Profesional

### **Neni 3 Autoriteti kompetent**

Autoriteti kompetent për zbatimin e procedurës së dhënies së Lejes Mjedisore Komunale, është Komuna.

### **Neni 4 Aplikimi**

- 4.1 Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet në Komunë, gjatë procedurës për marrjen e Lejes Ndërtimore.
- 4.2 Objektet ekzistuese, që nuk janë të nënshtruar kësaj Rregullore do të nënshtrohen dispozitave ligjore në bazë të Ligjit për Legalizim dhe ligjeve të tjera në fuqi.
- 4.3 Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve ose projekteve në mjedis në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis, sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214.

### **Neni 6 Paraqitja e kërkesës**

- 6.1. Për marrjen e lejes mjedisore komunale, aplikuesi duhet të dorëzojë komunës kërkesën të cilës i bashkëngjitet raporti i Lejes Mjedisore Komunale, tri (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike dhe dokumentet:
  - a) certifikatën për regjistrimin e biznesit;
  - b) fletën poseduese;
  - c) kopijen e planit me koordinata;
  - d) kontratën për shfrytëzimin e ngastrës, nëse ngastra nuk është pronë e aplikuesit.
  - e) Kërkesa duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, statusin juridik të aplikuesit dhe emrin e projektit.

### **Neni 7 Përmbajtja e raportit të Lejes Mjedisore Komunale**

- 7.1 Raport i Lejes Mjedisore Komunale, përmban:
  - a) përshkrimin e projektit;
  - b) përshkrimi i procesit teknologjik, pajimet;
  - c) identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis;
  - d) përshkrimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis.
  - e) Vlera e projektit
- 7.2 Raport i Lejes Mjedisore Komunale, nuk duhet të i tejkalon dhjetë (10) faqe

7.8 Raport i Lejes Mjedisore Komunale, duhet të përmban emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e hartuesit.

### **Neni 8**

#### **Përpiluesi i Raportit të Lejes Mjedisore Komunale**

8.1 Raporti i Lejes Mjedisore Komunale, hartohet nga personi fizik ose juridik

8.2 Raport i Lejes Mjedisore Komunale, nënshkruhet nga hartuesi dhe aplikuesi.

8.3 Hartuesi dhe aplikuesi i Raportit të Lejes Mjedisore Komunale, është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të përfshira në Raportin e Lejes Mjedisore Komunale.

### **Neni 9**

#### **Projektet që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale**

Procedurës së Lejes Mjedisore Komunale i nënshtrohen aktivitetet e përcaktuara në Shtojcën e Rregullores Komunale për dhënjen e Lejes Mjedisore Komunale .

### **Neni 10**

10.1 Për vlerësimin e raportit të Lejes Mjedisore Komunale, Kryetari, autorizon, Zyrtarin e lartë për Mbrojtje të Mjedisit /Sektorin e Mjedisit.

10.2 Zyrtari i lartë për Mbrojtje të Mjedisit, si udhëheqës i sektorit mjedisor formon Komisionin Profesional, të cilin Komision e miraton dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryetarit të Komunës.

### **Neni 11**

#### **Komisioni Profesional**

11.1 Komisioni Profesional përbehet nga 3 anëtar; Udhëheqësi/zyrtari i lartë /i sektorit të mjedisit dhe dy anëtarë të tjerë, me profesione përkatëse sipas natyrës së kërkesës që janë në trajtim.

11.2. Komisioni profesional (KP) në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Raportit, duhet të jep mendimin për miratim ose refuzim të dhënies së Lejes Mjedisore Komunale.

### **Neni 12**

Aplikuesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë Komunës, kundër vendimit për refuzim Lejes Mjedisore Komunale, brenda pesëmbëdhjete (15) ditësh nga data e publikimit të Vendimit për Lejes Mjedisore Komunale.

### **Neni 13**

#### **Afati për miratim**

13.1 Brenda afatit prej tridhjetë ditësh (30) ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës me raport të Lejes Mjedisore Komunale, në bazë të mendimit të Komisionit Profesional, zyrtari i mjedisor vendos për miratimin apo refuzimin te Lejes Mjedisore Komunale

13.2 Udhëheqësi/Zyrtari për Mbrojtjen e Mjedisit në bazë të kompetencave, vendos për miratim ose për refuzim të vendimit për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.

13.3 Subjektet ekzistuese, të cilat nuk janë të pajisura me Lejes Mjedisore Komunale,

obligohen që në afat prej 30 ditësh të bëjnë kërkesë për pajisje me Lejes Mjedisore Komunale, këto subjekte do të nënshtrohen procedurave konform kësaj Rregullore.

13.4 Lejes Mjedisore Komunale lëshohet për periudhën jo me gjatë se dhjet (10) vjeçare, vazhdimi i Lejes Mjedisore Komunale i nënshtrohet si në vijim.

#### **Neni 14**

Në rast të aksidentit në procesin teknologjik (pajimet) të subjekti afarist, të cilat mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejtë ose tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, komuna (inspektori i mjedisit), e shpall gjendjen e mjedisit të rrezikuar, ndërsa personi juridik dhe fizik duhet që menjëherë të ndërmerr masa të sanimit sipas raportit të Lejes Mjedisore Komunale, të paraparë për mbrojtje me shpenzimet e veta.

#### **Neni 15**

##### **Transferi i Lejes Mjedisore Komunale**

**15.1** Në rast se aplikuesi për Leje Mjedisore Komunale, ose poseduesi i një Lejes Mjedisore Komunale, planifikon të transferojë atë kërkesë ose leje te ndonjë person tjetër -trashëguesi, aplikuesi për LMK ose poseduesi i asaj leje dhe trashëguesi duhet të paraqesin një kërkesë të përbashkët në Komunë lidhur me atë transferim.

- a) Kërkesës për transfer i bashkëngjitet Leja Mjedisore Komunale origjinale.
- b) Komisioni parasheh shkaqet e mos transferimit p.sh ( borxhet komunale) etj.

#### **Neni 16**

##### **Ndërprerja e vlefshmërisë së Vendimit për Lejes Mjedisore Komunale**

16. 1 Ndërprerja e vlefshmërisë së Vendimit për Lejes Mjedisore Komunale, bëhet nëse:

- a) investitori nuk fillon realizimin e projektit në afat prej 2 vite;
- b) nuk i përmbush kushtet e përcaktuara me Lejes Mjedisore Komunale;
- c) në afatin e dhënë, nuk vepron sipas urdhëresave, këshillave të inspektorit ose nuk ndërmerr masat e kërkuara nga ai.

#### **Neni 17**

##### **Vazhdimi i afatit të Lejes Mjedisore Komunale**

Dy muaj para skadimit të afatit të Lejes Mjedisore Komunale, investitori duhet të parashtrij kërkesë për vazhdimin e afatit të Lejes Mjedisore Komunale, sipas procedurës për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale.

#### **Neni 18**

##### **Regjistri Lejes Mjedisore Komunale**

18.1 Komuna mban regjistrin për Lejeve Mjedisore Komunale, të lëshuara.

18.2 Regjistri i Lejes Mjedisore Komunale, përmban:

- a) numrin identifikues të investitorit;
- b) titullin dhe selinë e investitorit;
- c) adresën e investitorit;
- d) datën e lëshimit dhe afatin e Lejes mjedisore komunale;

e) lokacionin e projektit.

### **Neni 19**

Të hyrat nga taksat e Lejes Mjedisore Komunale duhet të dedikohen në projekte ambientale dhe të aprovohen nga Asambleja Komunale.

## **DISPOZITAT NDESHKUESE**

### **Neni 20**

#### **Kundërvajtjet**

20.1 Me gjobë në të holla prej pese mije (5.000) deri në 10.000 (dhjete mije ) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik ose fizik nëse jep të dhëna jo të sakta në Raportin për LMK-ën dhe në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje (neni 7 paragrafi 3.);

### **Neni 21**

21.1 Në gjobë në të holla prej ( 100) njëqint deri 300 (treqind) Euro,do të dënohen të gjitha subjektet ekzistuese, të cilat nuk janë të pajisura më Leje Mjedisore Komunale, (Neni 11 paragrafi 3), në përputhje me Rregulloren Komunale për Lartësinë e Taksave Ngarkesave dhe Gjobave Për Shërbimet Komunale.

21.2 Te gjitha subjektet ekzistuese do njoftohen me shkrim mbi miratimin e Rregullore Komonale për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, po ashtu për afatin e pajisjes me Leje Mjedisore Komunale.

**Sqarim:** (Tarife kjo e cila do inkorporohet në rregulloren Komunale sipas vendimit të marrë nga Kuvendi Komunal)

## **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 22**

Kësaj Rregulloreje i nënshtrohen të gjitha subjektet, të cilat operojnë në territorin e Komunës së Gjilanit, që nuk janë të nënshtuar procedurave të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis më Nr. 03/L-024, në shtojca më Nr. 1 dhe 2 po të këtij ligji.

### **Neni 23**

Në rast se dispozitat e kësaj rregullore bien ndesh me dispozitat ligjore, të cilat e trajtojnë dhe rregullojnë këtë veprimtari atëherë aplikohen dispozitat e Ligjeve në fuqi.

### **Neni 24**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore Komonale është shtojca e bashkangjitur, kategorizuar në gjashtë grupe, së bashku me shumën që duhet më paguar (çmimoren), subjektet për t'u pajisur me Leje Mjedisore Komunale janë të obliguar për të paguar shumat si në vijim:

#### **Shtojca:**

#### **Grupi i parë – 500€**

1. Fabrika për përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri 1000m<sup>3</sup>/vit
2. Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, mineral; me kapacitet deri në 0.5 m<sup>3</sup>në ditë

3. Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash,pije freskuese; pijesh alkoolike me kapacitet deri në .5 m<sup>3</sup>në ditë
4. Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij, deri 1000 kg/ditë
5. Fabrika për përpunim të vajrave bimore, lulediellit etj, me kapacitet 500l/ ditë.
6. Prodhimi i gëlqeres (shuarja) deri 100 ton/vit
7. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet deri në 50 m<sup>3</sup> beton/ditë
8. Magazini mi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vende prodhim
9. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktiv demolim për qëllime të riciklimit përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre si dhe caktimin e vendit për deponim
10. Prodhimi i këpucëve she aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa procese kimike(qepje,ngjitje montim)
11. Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri 500 kg/ditë
12. Rritja artificiale e peshkut në hurdhë, me sipërfaqe deri në 300 m<sup>2</sup>

#### **Grupi dytë -350€**

1. Pikëshitjet e gazit(GLN) deri 4.9 m<sup>3</sup>
2. Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit
3. Thertore me kapacitetet deri 3 gj edhe /ditë
4. Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve deri në 1000 kg/ditë
5. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit, me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m<sup>3</sup>
6. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000m<sup>2</sup>
7. Magazinat frigorifer, për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 ton.

#### **Grupi i tretë- 300€**

1. Sharrimi i lëndës drunore
2. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit
3. Impiantët për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se
  - 1). 2000 shpend
  - 2). 100 derra
  - 3). 30 gjedhë
  - 4). 200 bagëti të imëta

#### **Grupi i katërt-200€**

1. Autoserviset
2. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100m<sup>3</sup> ose 40 ton gjatë vitit
3. Vendet ku janë të magazinuar, më pas se 10 ton mbeturinë inerte
4. Vendet ku janë të magazinuar, më pak se 2 ton mbeturinë e pa rrezikshme
5. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000t/vit

#### **Grupi i pestë- 100€**

1. Autolarjet

2. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri ne 10 ton
3. Qebaptoret dhe gjellëtoret
4. Vendet e tregtimit të kafshëve në ambient të hapur(tregjet tradicionale) ose të mbyllura
5. Tregjet urbane industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore

#### **Grupi i gjashtë- të liruara**

Projektet Publike

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km
3. Rikonstruksion i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore ( me gjatësi deri në 2 km)
4. Plantacionet e drurëve frutore
- 5 .Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj;

#### **Neni 25**

Kjo Rregullore hynë në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi Komunal.

**Kryesuesja e Kuvendit.**

**Valentina Bunjaku-Rexhepi,**

---